

qika

**RAPORTI
VJETOR
MBI
FUSHËN
E DREJTËSISË
DHE
BARAZISË GJINORE
NË KOSOVË
2025**

QIKA

QENDRA PËR INFORMIM, KRITIKË DHE AKSION

Autore: Blendë Pira

©Ky publikim është prodhuar nga Qendra për Informim,
Kritikë dhe Aksion - QIKA, 2026

PËRMBAJTJA

Hyrje	8	Dhuna në familje ndaj grave	27
Përmbledhje Ekzekutive	9	Qasja në informata	29
Qasja në punësim	11	Qasja e grave në drejtësi	30
Puna e papaguar e grave	12	Qasja në strehimore	30
Puna joformale	14	Mbështetja pas qëndrimit në strehimore	32
Pushimi prindëror dhe Ligji i Punës	14	Qasja në punësim e grave që kanë përjetuar dhunë në familje	32
Qasja në pronë	16	Dënimet e ulëta ndaj abuzuesve të grave	33
Qasja në shëndetësi.....	17	Dhuna seksuale	35
E drejta në shëndet riprodhues dhe seksual	18	Dhunimi dhe sulmi seksual	36
Shëndeti mendor	19	Dhuna seksuale gjatë luftës	36
Diskriminimi i ndërthurur	20	Ngacmimet seksuale	37
Gratë e komuniteteve etnike jo shumicë	20	Dhuna përmes teknologjisë informative... 38	
Gratë LGBTI+	21	Gratë në sferën publike	38
Gratë me aftësi të kufizuara	22	Femicidi	41
Gratë me shami	22	Zhvillimet në vitin 2025 rreth rasteve të tjera të femicidit në Kosovë	43
Dhuna në baza gjinore	24		
Dhuna në baza gjinore ndaj komuniteteve LGBTQI+....	25		

HYRJE

Viti 2025 shënon vazhdimësinë e sfidave strukturore dhe shoqërore që ndikojnë në realizimin e të drejtave të grave në Kosovë, pavarësisht ekzistencës së një kornize ligjore që garanton barazinë gjinore. Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës, përfaqësimi i kufizuar në proceset vendimmarrëse dhe praktikatat patriarkale vazhdojnë të kufizojnë qasjen e tyre në mundësi ekonomike dhe sociale.

Njëkohësisht, dhuna në baza gjinore, përfshirë dhunën në familje, sulmet dhe ngacmimet seksuale, mbeten një shqetësim serioz, ndërsa grupet më të cenueshme përballen me barriera të ndërthurura për qasjen në të drejta dhe shërbime. Ndonëse viti 2025 është karakterizuar nga disa zhvillime pozitive, gratë vazhduan të përballen me sfida që kërkojnë veprim të menjëhershëm institucional dhe shoqëror.

Ky raport paraqet një pasqyrë të gjendjes gjatë vitit 2025, duke theksuar nevojën për zbatim më efektiv të legjislacionit dhe për angazhim më të madh institucional e shoqëror në avancimin e barazisë gjinore.

Kësajqë raportit ofron një përmbledhje të zhvillimeve kryesore që kanë ndikuar në të drejtat e grave gjatë vitit 2025 dhe nuk synon të përfshijë në mënyrë shteruese të gjitha ngjarjet dhe proceset e kësaj periudhe.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Në vitin 2025, vetëm 21.2% e grave në Kosovë janë të punësuar.
- Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në pozita vendimmarrëse, pavarësisht kornizës ligjore për barazi.
- Diskriminimi fillon që në aplikim për punë, ku kandidatët trajtohen ndryshe sipas gjinisë.
- Ngacmimi seksual dhe frika nga raportimi i dekurajon gratë të hyjnë ose të qëndrojnë në tregun e punës.
- Gratë mbajnë barrën kryesore të punës së papaguar shtëpiake, shpesh duke punuar orë të gjata edhe pas punës së paguar.
- Puna joformale dhe kontratat e pasigurta prekin më shumë gratë, duke rritur pabarazitë ekonomike.
- Dhuna në familje dhe dhuna gjinore mbeten shumë të përhapura, ku shumica e viktimave janë gra dhe dënimet shpesh janë të buta.
- Gratë nga komunitetet e marginalizuara (rome, ashkali, egjiptiane, LGBTI+, me aftësi të kufizuara) përballen me diskriminim të shumëfishtë në punësim, shëndetësi dhe të drejta themelore.
- Në shumë raste të femicidit, gjykatat kanë shqiptuar dënime të rënda përshtirë burgimin e përjetshëm, duke reflektuar seriozitetin e këtyre krimeve (p.sh. rastet e Gjyljeta Ukellit dhe Liridona Ademajt).



NDE
E ARDHME
ME E MIRE
ESHTE
E MUNDSHME

QUEERS

Foto nga marshi "Marshojmë S'festojmë" 2025
Credits: Zana Begalli

QASJA NË PUNËSIM

Edhe në vitin 2025 qasja e grave në punësim në Kosovë vazhdon të jetë një sfidë e madhe për shkak të një sërë faktorësh institucionalë, strukturorë dhe socialë. Nga të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të publikuara në vitin 2025, përqindja e grave të punësuar ishte 21,2%.^[1] Kosova mban vendin e parë në Evropë dhe renditet e pesta në nivel global për shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.^[2] Në nivel institucional gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësura në pozita vendimmarrëse.^[3]

Përgjegjësitë familjare, stereotipet gjinore, mungesa e çerdheve dhe shërbimeve sociale, diskriminimi, ngacmimet seksuale, pabarazitë në qasje në trajnime dhe pabarazitë në qasje ndaj pronës, mbetën të jenë ndër arsytet kryesore të kufizimit të qasjes së grave në punësim.

Hulumtimi “Paragjykimi në derë” i realizuar nga QKSGJ dhe IKS, tregon se diskriminimi mund të ndodhë që në procesin e aplikimit për punë, ku kandidatët me kualifikime të barabarta trajtohen ndryshe në bazë të gjinisë apo karakteristikave të tjera, duke kufizuar qasjen e tyre në punësim edhe para se të krijohet vetë marrëdhënia e punës.^[4]

^[1] Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet e Arsyetës së Fuqisë Punëtore (AFF) 2025*, 2025

^[2] Institut GAP, *Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: Potenciali i pashfrytëzuar i fuqisë punëtore joaktive*, 2025

^[3] Komisioni Evropian, *Dokument i Punës i Shërbimit të Komisionit – Raporti për Kosovën 2024 (SaQ/2024/752 final)*, 2025

^[4] QKSGJ dhe IKS, *Paragjykimi në derë: Hulumt i diskriminimit që mënyrë testimit të shërbimeve në tregun e punës*, 2025.

Një tjetër problem që i step gratë nga qasja në tregun e punës është edhe ngacmimi seksual në vendin e punës dhe mosbesimi në mekanizmat e raportimit. Për shkak të frikës nga hakmarrja, rastet e diskriminimit gjinor dhe ngacmimit seksual shpesh nuk raportohen, duke e thelluar nënraportimin dhe vazhdimësinë e pabarazive në vendin e punës.^[5]

Në anën tjetër shumë shpesh shpalljet për vende pune në Kosovë pasqyrojnë stereotipe gjinore, duke i orientuar gratë kryesisht në administratë, edukim dhe shëndetësi, ndërsa burrat në sektorë teknikë dhe industrialë. Gjuha e përdorur në titujt e vendeve të punës shpesh është e kodifikuar sipas gjinisë dhe e përforcon këtë ndarje. Kjo praktikë mund të dekurajojë gratë nga aplikimi dhe të thellojë pabarazitë në tregun e punës.

PUNA E PAPAGUAR E GRAVE

Sipas një hulumtimi të Fondacionit Jahjaga, puna e papaguar e përkujdesit në Kosovë mbetet kryesisht përgjegjësi e grave, duke reflektuar një ndarje tradicionale gjinore të roleve brenda familjes.^[6] Të dhënat nga ky hulumtim tregojnë se mbi 90% e grave të anketuara (gjithsej 196 të anketuar) bartin pjesën më të madhe të punëve shtëpiake, ndërsa burrat zakonisht kontribuojnë vetëm në mënyrë sporadike. Për shumë gra, përkujdesi përbën një “ndërrim të dytë”, pasi ato vazhdojnë me detyra shtëpiake edhe pas angazhimeve të paguara. Rreth 43.3% e të anketuarve, kryesisht gra, deklaruan se shpenzojnë të paktën tre orë në ditë në punë të papaguar, ndërsa 9% raportuan mbi gjashtë orë, krahasuar me vetëm 12% të të anketuarve, kryesisht burra, që shpenzojnë më pak se një orë në ditë për këto detyra.^[7]

^[5] OJSGU & IKS, Document / pozicionimi: Diskriminimi me bazë gjinore në tregun e punës në Kosovë, 2025.

^[6] Fondacioni Jahjaga, Fajja Punitore e Parakalimes: Përkujdesi si Punë e Papaguar në Kosovë dhe Rrugat e Drejta Zhvillimit të Rrethit të Rrethorë Glasov, 2025.

^[7] Po aty

A woman with long blonde hair, wearing a blue long-sleeved shirt, is holding a large red protest sign. She is looking upwards and to the right. The sign has text in Albanian. In the background, other people are visible, some holding up their phones, suggesting a public demonstration or rally.

Punët e shpisë **NUK**
janë punë të grave!

PUNA JOFORMALE

Puna joformale vazhdon të mbetet një nga sfidat më të mëdha për matjen e saktë të punësimit në Kosovë edhe gjatë vitit 2025, ku një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore vazhdon të operojë jashtë kornizave formale. Gratë në Kosovë vazhdojnë të përballen me pabarazi në tregun e punës, duke u punësuar në mënyrë disproporcionale përmes kontratave me afat të caktuar ose në sektorin joformal.^[8]

Në dhjetor të vitit 2024 u raportua se punëtorët me prejardhje filipineze në Kosovë shpesh përballen me kushte të vështira pune, përfshirë orë të gjata, paga të ulëta dhe raste të raportuara abuzimi, ndërsa shumë prej tyre heshtin për shkak të frikës nga humbja e vendit të punës ose dëbimi, duke mbetur të ekspozuar ndaj shfrytëzimit për shkak të varësisë nga punëdhënësit dhe mungesës së mbrojtjes efektive institucionale.^[9] Sipas këtij artikulli, punësimi i këtyre grave është plotësisht joformal.

PUSHIMI PRINDËROR DHE LIGJI I PUNËS

Gjatë vitit 2025 Ligji i ri i Punës nuk arriti të miratohet, duke vazhduar kështu një zvarritje disavjeçare të reformave edhe sa i përket pushimit prindëror. Pavarësisht premtimeve të vazhdueshme institucionale për ndryshime, përfshirë edhe deklaratimet për sigurimin e pushimit të paguar për të dy prindërit, nuk u shënuan hapa konkretë drejt miratimit të këtij ligji.^[10]

^[8] OESGJ dhe IKS, STUDIMI RAJZE AMI DISKRIMINIM GJINOR NË VENDIN E PUNËS, janar 2025

^[9] Radio Evropa e Lirë, Punëtorët filipinezë në Kosovë duan të abuzimet në heshtje, 2024

^[10] Klan Kosova (2025) "Një qershi 12 muaj, qytetë lehonë me qershi" mosje, oer të dy prindërit për pagë në një ndryshim, 2026.

Një nga arsyt kryesore ishte fakti se gjatë vitit 2025, Kosova u përball me një periudhë të zgjatur të destabilitetit politik dhe institucional.

Në anën tjetër, organizatat e shoqërisë civile, përfshirë Forumin Ekonomik të Grave (FEG), vazhduan avokimin për ndryshime ligjore, duke propozuar modele që synojnë uljen e barrës financiare për sektorin privat dhe rritjen e përfshirjes së grave në tregun e punës. Një nga propozimet kryesore ishte që shteti të marrë përsipër pagesën e pushimit të lehonisë për një pjesë të konsiderueshme të periudhës, si dhe të zgjerohet pushimi prindëror për të dy prindërit, në përputhje me praktikat evropiane.^[11]

Sipas raportimeve në media, disa studente specializante në Kosovë, detyrohen të kompensojnë periudhën e pushimit të lehonisë më vonë përmes punës shtesë, shpesh pa pagesë, gjë që ngre shqetësime për shkelje të të drejtave të punës dhe diskriminim ndaj grave në sistemin shëndetësor.^[12] 67 mjeke specializante dorëzuan një petition në Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës dhe në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, përmes të cilit e cilësuan këtë qasje institucionale si të padrejtë dhe diskriminuese.^[13]

Gjykata e Apelit e Kosovës në shkurt të vitit 2025, me aktgjykimin AC.nr. 399/22, vendosi një precedent në lidhje me pushimin e lehonisë. Sipas aktgjykimit punëdhënësi nuk ka detyrim të kompensojë pushimin e lehonisë pas skadimit të kontratës me afat të caktuar, pasi marrëdhënia e punës përfundon automatikisht me skadimin e saj, dhe mosvazhdimi i kontratës nuk konsiderohet shkëputje e paligjshme sipas Ligjit të Punës.^[14]

^[11] Forumi Ekonomik i Grave (FEG), "FEG prezanton modelin për ndryshimin e Ligjit të Punës në Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime", maj 2025.

^[12] OJKA, "Specializantët detyrohen të punojnë pa pagesë gjatë kompenimit të lehonisë", 2025

^[13] Po aty

^[14] Shoqëria e Avokatëve "Vollëti & Lati", "Ruajtjet Njerëzore dhe Ligji i Punës - Përmbledhje e Vendimeve të Bërditshme", 2025.

QASJA NË PRONË

Në vitin 2025, Qeveria e Kosovës miratoi Udhëzimin Administrativ nr. 03/2025, i cili parasheh masa për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve në regjistrin kadastral. Ky vendim synon forcimin e barazisë gjinore dhe nxitjen e regjistrimit të pronës si bashkëpronësi.^[15]

Megjithatë, në vitin 2024 u raportua se gratë ishin pronare të vetëm 19.8% nga 612,482 prona të regjistruara, duke përfshirë edhe ato që i zotërojnë bashkë me burrat.^[16]

Sipas të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, deri më 3 korrik 2026 ishin regjistruar gjithsej 668,620 pronarë të pronës. Nga ky numër, 512,939 (76.72%) ishin burra, ndërsa 142,848 (21.36%) ishin gra dhe pjesa tjetër persona juridik.^[17]

Bazuar në monitorimin e 60 rasteve dhe 172 seancave gjyqësore, raporti i Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) evidenton se gratë në Kosovë vazhdojnë të përballen me barriera strukturore në ushtrimin e të drejtave pronësore, pavarësisht garancive formale ligjore për barazi.^[18] Analiza tutje tregon se këto sfida lidhen kryesisht me sistemin gjyqësor, përfshirë vonesat procedurale, mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe administrative, si dhe mangësitë në përfaqësimin ligjor dhe transparencën e proceseve gjyqësore. Raporti gjithashtu vë në pah se praktikatat patriarkale vazhdojnë të ndikojnë veçanërisht në çështjet e trashëgimisë dhe në ndarjen e pasurisë pas divorcit, ku shpesh nuk njihet në mënyrë të plotë kontributi jofinanciar i grave në martesë.^[19]

^[15] ECHA.net, Qeveria miraton udhëzimin për masat e raportit për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, Mars, 2025.

^[16] UN Women, Profili Gjinor i Kosovës, nëntor 2024, faqe 37

^[17] Agjencia Kadastrale e Kosovës, Statistikat e Kadastrit 2026

^[18] Group for Legal and Political Studies (GLPS), Monitorimi i rasteve gjyqësore për të drejtat pronësore të grave në Kosovë, 2025

^[19] Ito aty

Gratë rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë përballen me pengesa të mëdha në ushtrimin e të drejtave pronësore dhe trashëgimore, pavarësisht garancive ligjore për barazi.^[20]

Në praktikë, këto të drejta kufizohen nga diskriminimi gjinor, marginalizimi socio-ekonomik, si dhe nga norma kulturore dhe struktura patriarkale që vazhdojnë të ndikojnë në mënyrën e shpërndarjes së pronës dhe trashëgimisë.

QASJA NË SHËNDETËSI

Në shumë zona rurale të Kosovës, qasja në shërbime bazike shëndetësore dhe në kujdesin për shëndetin riprodhues mbetet e pamjaftueshme.^[21] RrGK raporton se kjo situatë lidhet kryesisht me mungesën e investimeve, e cila ka shkaktuar deficit të pajisjeve mjekësore dhe profesionistëve shëndetësorë, si dhe ka ndikuar në uljen e cilësisë së shërbimeve, përfshirë ato të maternitetit dhe emergjencës. Gratë nga komunitetet jo-shumicë shpesh hasin pengesa shtesë, duke e bërë edhe më të vështirë qasjen në kujdes shëndetësor.^[22]

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2025, në Kosovë janë vaksinuar mbi 13,000 fëmijë të moshës rreth 12-vjeçare me vaksinë kundër HPV-së, e vaksinimi do të vazhdojë edhe tek grupmoshat e tjera.^[23]

Në anën tjetër, në qershor të vitit 2024 në Kosovë ka filluar dhënia e terapisë parandaluese kundër infeksionit nga virusi HIV, përpara se të ndodhë ekspozimi ndaj tij.^[24] Për këtë terapi e cila quhet PrEP, në 2025, janë regjistruar 34 raste të reja, ndërsa 14 persona kanë vazhduar trajtimin nga viti paraprak.^[25]

^[20] Advocacy Training and Resource Center (ATRC) & Advancing Together (AT). Policy Paper: Property Rights Challenges for Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo, 2025

^[21] RrGK, Përmirësimi i Qasjes së Grave në Kujdesin Shëndetësor në Zona Rurale të Rahovecit, 2025

^[22] Po aty

^[23] Radio Evropa e Lirë, Vaksinimi kundër HPV-së: Mbi 13 mijë fëmijë të vaksinuar në Kosovë, maj 2025.

^[24] Radio Evropa e Lirë, Në Kosovë fillon të jetë terapija për parandalimin e infeksionit nga virusi HIV, qershor 2024.

^[25] Kallio.com, Rritje e përdorimit të barnave parandaluese kundër HIV në ORUK, 2025

E DREJTA NË SHËNDET RIPRODHUES DHE SEKSUAL

QIKA vazhdoi angazhimin publik për heqjen e taksës prej 18% ndaj produkteve menstruale, duke theksuar se kjo politikë jo vetëm që rëndon financiarisht gratë në Kosovë, por edhe mirëmban stigmën ndaj menstruacioneve si diçka e turpshme. Organizata ngriti shqetësimin se shumë gra, për shkak të varfërisë dhe varësisë ekonomike, nuk kanë qasje në produkte bazike higjienike dhe detyrohen të përdorin alternativa të pasigurta për shëndetin.^[26] 71 organizata të shoqërisë civile mbështetën letrën publike nga QIKA drejtuar Ministrisë së Financave, Punës, dhe Transfereve për heqjen e menjëhershme të TVSh-së dhe tarifave doganore për produktet menstruale.

Një artikull i publikuar nga Kosovo 2.0 shqyrton përvojat e grave në Kosovë që i nënshtrohen fekondimit të asistuar (IVF), duke evidentuar sfidat emocionale, fizike dhe financiare që shoqërojnë këtë proces, si dhe kufizimet në qasjen ndaj këtyre shërbimeve brenda sistemit shëndetësor publik.^[27] Për shkak se IVF nuk ofrohet ende në mënyrë funksionale në sistemin publik shëndetësor, shumë gra detyrohen të kërkojnë trajtim në klinika private, duke i lënë pa standardizim rigoroz, mbikëqyrje të plotë dhe masa ndëshkuese efektive në rast të shkeljes së procedurave. Përveç kostos së lartë, ato përballen edhe me stres, pasiguri dhe presion shoqëror, ndërsa mungesa e shërbimeve publike dhe mbështetjes institucionale e bën rrugëtimin drejt prindërimit edhe më të vështirë.

Gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2025, QIKA, bashkë me Rrjetin e Grave të Kosovës dhe Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, kritikoi premtimet elektorale që parashihnin

[26] QIKA, Taksa menstruale mirëmban stigmën, 2025

[27] K2.0, Drejt qendërimit me IVF, 2025

pagesa dhe mbështetje financiare të lidhura me lindshmërinë, duke argumentuar se ato e trajtojnë rolin e grave kryesisht përmes funksionit riprodhues.^[28] Organizatat shprehen shqetësimit se politika të tilla mund të përforcojnë rolet tradicionale gjinore dhe të ndikojnë në autonominë e grave, ndërsa bëri thirrje për politika që fokusohen në barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, ndarjen e përgjegjësisë të kujdesit dhe mbrojtjen e të drejtave riprodhuese.

SHËNDETI MENDOR

Shëndeti mendor në Kosovë ndikohet nga një sërë faktorësh si ato sociale, shëndetësorë, mjedisorë, ekonomik dhe të tjerë, të cilët shpesh ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe rrisin rrezikun e çrregullimeve psikologjike, veçanërisht te grupet më të cenueshme të shoqërisë. Artikulli i Kosovo 2.0 mbi shëndetin mendor të nënave në periudhën pas lindjes thekson se kjo fazë shpesh shoqërohet me rrezik të lartë për çrregullime emocionale, veçanërisht depresionin post-partum, i cili mbetet i nën-diagnostifikuar dhe i stigmatizuar në kontekstin shoqëror në Kosovë.^[29] Ky artikull, që shpërfaqë përvoja të grave pas lindjes, nënvizon se nënat shpesh përballen me mungesë të mbështetjes sistematike shëndetësore dhe psikologjike, ndërsa diskursi dominues social i orienton ato ekskluzivisht drejt kujdesit për foshnjën, duke e minimizuar nevojën për mirëqenie të tyre mendore. Kjo situatë reflekton një boshllëk të rëndësishëm në integrimin e shëndetit mendor në kujdesin perinatal dhe thekson nevojën për ndërhyrje institucionale dhe ndërgjegjësim më të gjerë publik.^[30]

Në kontekstin e sfidave të shumta që ndikojnë në shëndetin mendor në Kosovë, një ndër faktorët e rëndësishëm dhe shpesh të nënvlerësuar është edhe ndikimi i ndryshimeve klimatike. Këto ndryshime ndikojnë veçanërisht te grupet vulnerable si të moshuarit, personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe fëmijët.^[31]

^[28] OCHA, [Politika për barazi gjinore dhe riprodhimin](#), 2025.

^[29] Kosovo 2.0, [Tërbëimi i mirëqenies gjinore në nënat pas lindjes](#), 2025.

^[30] Ilo aty.

^[31] OCHA, [Ndryshimet klimatike që kontribuojnë në rritjen e sëmundjeve në Kosovë](#), 2025.

DISKRIMINIMI I NDËRTHURUR

Një përparësi për viktimat që raportojnë diskriminimin në Kosovë është se Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konkretisht neni 20 i këtij ligji, thekson se kur një person paraqet fakte që krijojnë dyshim se ka ndodhur diskriminim, barra e provës kalon te pala tjetër, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.^[32] Andaj, gratë inkurajohen të raportojnë çfarëdo forme të diskriminimit dhe të ndjekin procedurat gjyqësore në mënyrë që t'i realizojnë të drejtat e tyre.

GRATË E KOMUNITETEVE ETNIKE JO- SHUMICË

Martësat e hershme, veçanërisht tek gratë rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë, vazhdojnë të konsiderohen një fenomen shqetësues me pasoja të shumta sociale dhe ekonomike.^[33] Kjo dukuri ndikon drejtpërdrejt në ndërprerjen e arsimit të vajzave, duke kufizuar mundësitë e tyre për zhvillim personal dhe integrim në tregun e punës.

QKSGJ dhe IKS në një raport të fundit tregojnë se gratë rome përballen me trajtim të pabarabartë që në fazat e hershme të procesit të punësimit.^[34] Gjetjet e tyre theksojnë se gjatë intervistave, këto gra hasin barriera si vënia në dyshim e arsimit, theksimi i vështirësive praktike si transporti dhe ofrimi i kushteve më të pafavorshme të punës. Raporti gjithashtu evidenton raste ku kandidatet rome, edhe kur janë më të kualifikuara, nuk përzgjidhen për pozita pune në krahasim me kandidatet jo-rome, duke reflektuar praninë e paragjyimeve etnike në procesin e rekrutimit.^[35]

^[32] Kuvendi i Kosovës, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Neni 20.

^[33] ZGM & Tdh, Raporti i Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (2022-2024), 2025.

^[34] QKSGJ dhe IKS, Paragjyrimi në drejtë: Zhvillimi i diskriminimit qërrasë testimit në situatave në tregun e punës, 2025.

^[35] *Ido aty*

Sipas raportimeve gratë rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë shpesh përballen me mungesë informacioni dhe barriera sociale, kulturore dhe ekonomike që i pengojnë të kenë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore, përfshirë kontrollin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, duke i bërë këto komunitete më të izoluar në fushatat e vetëdijesimit dhe parandalimit.^[36]

GRATË LGBTI+

Edhe viti 2025 nuk solli ndonjë risi në miratimin e Projekt-Kodi Civil, e bashkësitë civile për personat e seksit të njëjtë vazhdojnë të mos njihen ligjërisht.

Sipas raportit të CEL Kosova, Konventa CEDAW ka zgjeruar interpretimin e saj për të përfshirë edhe përvojat e grave lezbike, biseksuale dhe transgjimore, duke theksuar se dhuna dhe diskriminimi ndaj tyre janë pjesë e fushëveprimit të saj. Në këtë kuadër, Kosova ka detyrim të ndërmarrë masa konkrete për të adresuar sfidat specifike me të cilat përballen gratë LGBTI+, përfshirë pengesat në raportimin e dhunës, paragjykimet institucionale dhe mungesën e qasjes në shërbime të sigurta dhe gjithëpërfshirëse.^[37] Megjithatë, gratë LGBTI+ vazhdojnë të përballen me diskriminim në fusha të ndryshme, steroitipizim e gjuhë të urrejtjes.

Më 23 qershor 2025, aktivistet Arlinda Morina dhe Uresa Ahmeti dorëzuan kallëzim penal në Prishtinë ndaj një personi (D.R.) për nxitje të urrejtjes dhe përçarjes ndaj komuniteteve LGBTIQ+, pasi ai kishte shpërndarë në Twitch një video me përmbajtje denigruese gjatë një livestream-i.^[38] Sipas kallëzimit, përmbajtja u përhap edhe në platforma të tjera, duke rritur ndikimin e gjuhës së urrejtjes, ndërsa në disa raste aktivistet ishin identifikuar dhe

^[36] Radio Evropa e Lirë, [Gratë rome, ashkale e egjiptiane më epi të informimit për kancerin e gjirit](#), 2025.

^[37] Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), [Ecuria e Paqartësi Ligjorë në Drejtat e Personave LGBTI+ në Kosovë: Zhvenditjet, Vonesat dhe Rrugat Përmirësimi](#), 2025.

^[38] OJKA, ["Drejtësi dhe Barazi: Kallëzim penal ndaj një personi që nxitte në urrejtje ndaj komunitetit LGBTIQ+", 2025](#)

shënjestruar drejtpërdrejt në video, çka u cilësua si rrezikim personal dhe tentim linqimi. Sipas tyre, veprimet e personit përbëjnë veprat penale “nxitje e përçarjes dhe mosdurimit” dhe “kanosje”.^[39]

GRATË ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në shkurt të 2025-tës në Gjilan u mbajt një protestë e organizuar nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist dhe organizata të tjera, në reagim ndaj një rasti të dhunës së rëndë fizike dhe të dyshuar seksuale ndaj një gruaje me aftësi të kufizuara, ku protestuesit/et denoncuan dhunën strukturore dhe dështimin institucional për mbrojtjen e kësaj kategorie, duke kërkuar nga autoritetet lokale që të ofrojnë mbështetje konkrete, shërbime të sigurta dhe të rishikojnë politikat sociale për trajtimin e rasteve të tilla.^[40]

GRATË ME SHAMI

Në vitin 2025, Gjykata Supreme e Kosovës e ka hedhur poshtë padinë e Rrjetit të Femrave për Zhvillim Profesional “Arrita” që kërkonte lejin e bartjes së shamisë islame në shkolla, duke vlerësuar se Ministria e Arsimit ka të drejtë ligjore të përcaktojë rregullat e veshjes për nxënësit.^[41] Padia argumentonte se ndalimi cenon lirinë fetare të vajzave që mbajnë shaminë islame, e njohur edhe si hixhab, por gjykata vendosi se ky kufizim mbështetet në ligj dhe nuk mund të shfuqizohet, duke lënë në fuqi ndalesën për simbolet fetare në shkolla.^[42]

^[39] Po aty

^[40] CINEA, *Protestohet në Gjilan kundër dhunës strukturore ndaj grave me aftësi të kufizuara* 2025

^[41] Radio Evropa e Lirë, *Sqarësimi e kërshë: qasëti një qast për mbështetjen islame në shkollat e Kosovës* 2025

^[42] Po aty

Pas vendimit të Gjykatës Supreme, QIKA reagoi duke ngritur shqetësime për paqartësitë në Udhëzimin Administrativ 06/2014.^[45] Sipas organizatës, mungesa e një përkufizimi të qartë të termit “uniformë fetare” ka mundësuar interpretime të ndryshme dhe raste të përjashtimit të vajzave që bartin shami. Si reagim, QIKA kërkoi rishikimin e udhëzimit dhe masa që sigurojnë trajtim të barabartë dhe qasje të pandërprerë në arsim për të gjitha vajzat.

^[45] QIKA, Të gjitha vajzat me qasa qe shami e hane vendin në shkolle, 2025

**DHUNA
NË BAZA
GJINORE**

Dhuna në baza gjinore mund të ndodhë në çdo mjedis, përfshirë familjen, shkollën, vendin e punës, hapësirat publike dhe online, dhe shfaqet në forma të ndryshme si dhuna fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale, si dhe përmes praktikave të dëmshme tradicionale, përfshirë martesat e hershme dhe gjymtimin e organeve gjentiale femërore.^[44]

QIKA, në një reagim të vitit 2025, kritikoi performancën e këngëtarit Feronit Shabani (Fero) në festivalin “Aull n’Verë” të organizuar nga Komuna e Prishtinës, duke theksuar se ai po përballlet me akuza për dhunë në familje, ngacmim seksual dhe kanosje ndaj ish-partneres.^[45] Organizata e cilësoi pjesëmarrjen e tij në një ngjarje publike të financuar nga institucionet si normalizim të dhunës me bazë gjinore dhe kërkoi që institucionet publike të mos promovojnë persona të përfshirë në raste të tilla. QIKA i bëri thirrje Komunës së Prishtinës për përgjegjësi institucionale dhe kërkoi zbatimin e politikave të qarta gjinore në organizimin e eventeve publike.^[46]

DHUNA NË BAZA GJINORE NDAJ KOMUNITETEVE LGBTQ+

Një ndër grupet më të cënueshme në shoqëri janë personat LGBTQ+. Kjo përshkak të stereotipizimeve, gjuhës së urrejtjes, kërcënimeve, diskriminimit, dhunës e shumë faktorëve të tjerë që i vendosin këta persona në pozitë të ndjeshme. Rastet e dhunës dhe gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBTQ+ shpesh nuk klasifikohen si të tilla dhe nuk trajtohen si krime të motivuara nga orientimi apo identiteti.^[47] Sipas RRGK, kjo, së bashku me frikën nga diskriminimi dhe shkelja e konfidencialitetit, i dekurajon personat LGBTQ+ të kërkojnë ndihmë.

^[44] Bjeli i Grave të Kosovës (RrGK), Raporti dhunës dhe kërkimi ndihmë.

^[45] QIKA, Dhuvësit nuk kanë vend në shtet publike, 2025.

^[46] Po aty.

^[47] Bjeli i Grave të Kosovës (RrGK), Raport monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (SEMORF), 2022.

Sipas organizatës CSGD, 70% e qytetarëve të Kosovës besojnë se personat LGBTIQ+ nuk duhet të kenë barazi në martesë.^[48] Në një artikull të publikuar nga kjo organizatë theksohet se rinia shpesh mbetet pasive ose e heshtur përballë këtyre zhvillimeve, gjë që lejon forcimin e këtyre narrativave dhe pengon avancimin e barazisë dhe të drejtave.^[49]

Lëvizjet anti-gjinore në Kosovë po përhapen përmes dezinformimit dhe diskurseve politike, duke ndikuar në qëndrimet shoqërore dhe duke rritur gjuhën e urrejtjes ndaj komuniteteve LGBTIQ+.^[50]

Në një deklaratë të kryetarit të komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, homoseksualiteti u cilësua si "defekt gjenetik".^[51] Deklarata të tilla mund të kontribuojnë në përforcimin e paragjyimeve dhe stigmatizimit ndaj komuniteteve LGBTIQ+, duke ndikuar negativisht në përpjekjet për barazi dhe përfshirje shoqërore.

Gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2025, subjekti politik "Koalicioni për Familje" u gjosit disa herë nga PZAP-ja për përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe nxitëse ndaj komuniteteve LGBTIQ+. Këto dënime erdhën pas ankesave të organizatave CEL dhe Dylberizm, të cilat argumentuan se deklaratat e kandidatëve shkelnin Kodin e Mirësjelljes që ndalon nxitjen e dhunës dhe intolerancës. Megjithatë, përkundër gjobave fillestare që arrinin vlerën e mijëra eurove, Gjykata Supreme shfuqizoi njërin prej këtyre vendimeve, duke shkaktuar shqetësim tek aktivistët për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.^[52]

^[48] Qëndra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD), <https://www.facebook.com/photo/?fbid=128124947578179&set=a.559246796240168>, 2025

^[49] CSGD, Lëvizjet anti-gjinore dhe rinia që hesht, 2025

^[50] Po aty.

^[51] OIKA, Qëndrimi i njëri defekt, 2025

^[52] Institutit Sakshmet, Barazimi Politik i Personave LGBTIQ+: Analizë e Progresit Politik, Qëndrimeve dhe Grupave Rinorë të Partive gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2025, 2025

DHUNA NË FAMILJE NDAJ GRAVE

Sipas databazës për evidentimin e rasteve të dhunës në familje të Ministrisë së Drejtësisë, në vitin 2025, 84% e kryesve të dhunës në familje janë burra. Statistikat konfirmojnë se 3 në çdo 4 viktimë të dhunës në familje janë gra.^[53]

Sipas raportit të GLPS, nga rastet e raportuara nga Policia e Kosovës, 36.3% ose 1,026 janë bashkëshortët ata që ushtrojnë dhunë ndaj grave të tyre. Pra, dhuna bashkëshortore përbën formën më të zakonshme të dhunës në familje, duke pasuar nga 13.1% ose 370 burra që kishin ushtruar dhunë ndaj partnereve të tyre bashkëjetuese (grave) dhe 5.7% e kryesve të dhunës, ose 160 raste, përbëheshin nga ish-bashkëshortë që kishin ushtruar dhunë ndaj ish-grave të tyre.^[54]

Në 87% të rasteve të zgjidhura janë shqiptuar dënime nga gjykatat, megjithatë vetëm rreth një e treta e të pandehurve janë dënuar me burgim efektiv, ndërsa në 85% të rasteve të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për dhunë në familje.^[55]

Gjyqtarja Naime Krasniqi-Jashanica është degraduar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Divizionin për Kundërvajtje pas një procesi disiplinor të nxitur nga një incizim i publikuar, i cili ngriti dyshime për cenim të paanshmërisë dhe integritetit të saj në trajtimin e një rasti të dhunës në familje, ndërsa kjo është hera e dytë që ajo përballet me një masë të tillë që nga viti 2022, raporton Betimi për Drejtësi.^[56]

^[53] Ministria e Drejtësisë, <http://ml.dia.gov.net/publikimet/statistikat/>

^[54] GLPS, Performanca dhe Mospërfundim i Trajtimi Institucional i Dhunës në Familje në 2025, 2026

^[55] Po aty.

^[56] Betimi për Drejtësi, Gjyqtarja Naime Krasniqi-Jashanica degradohet në Divizionin për Kundërvajtje, ishte degraduar edhe në 2022, 2026

Në janar të vitit 2025, Gjykata Themelore në Mitrovicë e dënoi me 4 vite burgim Leotrim Shalën, i cili u shpall fajtor për shtytjen në vetëvrasje të të fejuarës së tij 19-vjeçare, Betina Ymerit.^[57] Sipas aktgjykimit, i akuzuari kishte ushtruar presion të vazhdueshëm psikik dhe maltretim ndaj viktimës, duke çuar në aktin tragjik të shtatorit të vitit 2022 pas një komunikimi të drejtpërdrejtë me video.^[58]

Rreth 60 organizata të shoqërisë civile dhe mediave në Kosovë reagues kundër një marrëveshjeje të Prokurorisë së Prishtinës që parashihte dënime shumë të ulëta (rreth 2,000–2,500 euro gjobë) për tre persona që kishin ngacmuar një gazetare të KALLXO.com në kuadër të grupit “AlbKings”.^[59] Gjykata Themelore në Prishtinë i shpalli fajtorë tre të akuzuar në rastin “AlbKings” për veprën e ngacmimit dhe i dënoi me gjithsej 7 mijë euro gjobë, duke paralajmëruar se mos-pagesa do të zëvendësohet me burg.^[60]

Gjykata Themelore në Prishtinë e dënoi Florent Poroshicën, krijues dhe menaxhues i grupit “AlbKings”, me 21 muaj burgim dhe 5 mijë euro gjobë për përfshirjen e tij në këtë rast.^[61]

Në reagimin e saj ndaj emisionit të RTV Dukagjinit “Dhunë në familje?! Si qëndron e vërteta?”, QIKA kritikoi mënyrën e trajtimit mediatik të rastit të denoncimit për dhunë në familje ndaj Valon Sylës.^[62] QIKA vlerësoi se paraqitja e tij në emision, ndërkohë që rasti ende nuk kishte epilog institucional, relativizonte seriozitetin e dhunës në familje dhe mund të dërgonte mesazhe të dëmshme për viktimat. QIKA reagoi gjithashtu ndaj toneve ironike dhe deklaratave kundër organizatave të grave të shfaqura gjatë emisionit, duke paralajmëruar se do të paraqesë ankesë në Komisionin e Pavarur të Mediave për shkelje të Kodit të Etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në Republikën e Kosovës.^[63]

^[57] QIKA, [Fajtor i jetë burgim të akuzuarit për shtytje në vetëvrasje të Betina Ymerit](#), 2025

^[58] Po aty

^[59] [Kallxo.com, Reagimi i 60 organizatave kundër marrëveshjes për dënime të ulëta të ngacmuesve të gazetares së KALLXO.com](#), 2025

^[60] [Betimi për Drejtësi, 2 mijë euro gjobë ndaj tre të akuzuarve në rastin e riçbur si “AlbKings”](#), 2025.

^[61] [Gazeta Express, Dënohet me 21 muaj burgim dhe 5 mijë euro gjobë Florent Poroshici i riçur dhe menaxhues i grupit “AlbKings”](#), 2025

^[62] QIKA, [Mediet në relativizim të dhunës, habesin krahëfajtorë](#), 2025

^[63] Po aty

**QASJA NË
INFORMATA**

QASJA E GRAVE NË DREJTËSI

Për gratë viktimë të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, qasja në drejtësi dhe mbrojtja nga shteti është thelbësore që ato të ndjehen të mbrojtura dhe të sigurta. Në anën tjetër, një sistem efektiv i drejtësisë, ku kryesisht dënohen në mënyrë meritore, ndihmon në parandalimin e rasteve të tjera, duke dërguar mesazh se dhuna nuk tolerohet dhe se autorët mbahen përgjegjës.

Edhe në vitin 2025, gratë viktimë vazhduan të përfitojnë ndihmë juridike falas nga një numër i organizatave jo-qeveritare si Instituti i Kosovës për Drejtësi, CLARD dhe të tjera. Sipas Ligjit Nr. 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore u ofrohet ndihmë juridike falas pavarësisht përmbushjes së kriterëve të zakonshme ligjore.^[64]

QASJA NË STREHIMORE


Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafik nga databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje në vitin 2025, e Ministrisë së Drejtësisë, në nivel vendi janë strehuar gjithsej 160 gra dhe 181 femijë.

Në Ligjin për Buxhetin e vitit 2025, ishte paraparë një rritje e konsiderueshme e fondeve për Shpenzimet Bazike për Strehimoret duke arritur në 2,500,000 €, kurse për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në 542,146 €.^[65]

^[64] Kusveti i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, 2022.

^[65] Gazeta Zyrtare, Ligji dhe Ndryshet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës Së Kosovës Për Vitin 2025, dhjetor 2024

**GRAFIKONI 1: NUMRI I GRAVE DHE FËMIJËVE TË STREHUAR,
GRAFIKONI NGA MINISTRIA E DREJTËSISË, KOSOVË.**



MBËSHTETJA PAS QËNDRIMIT NË STREHIMORE

Gjatë vitit 2025, janë paraqitur gjithsej 49 kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të qirasë nga të mbijetuarat e dhunës në familje në Komunën e Prishtinës, prej të cilave 44 janë aprovuar, ndërsa 5 janë refuzuar.^[66] Shuma totale e aprovuar arrin në 113,000€, duke përfshirë jo domosdoshmerisht vetëm komponentë për banim/qira, por edhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe shtesa për fëmijë. Sipas përgjigjeve të pranuar nga Komuna e Prishtinës, refuzimet kanë ndodhur kryesisht për shkak se aplikueset kanë qenë rezidente të komunave të tjera, çka sipas legjislacionit në fuqi nuk bie në mandatin e Komunës së Prishtinës për subvencionim. Sa i përket pyetjes se a ka pasur ndryshime në kriteret e përcaktuara për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, dhe si është përcaktuar kohëzgjatja e ndihmës financiare, Komuna e Prishtinës është përgjigjur se nuk ka pasur ndryshime në kriteret e përcaktuara, pasi vendimi fillestar vazhdon të mbetet në fuqi. Ndërkohë, kohëzgjatja e përkrahjes financiare përcaktohet në përputhje me kohëzgjatjen e urdhrat mbrojtës.^[67]

QASJA NË PUNËSIM E GRAVE QË KANË PËRJETUAR DHUNË NË FAMILJE

Sipas nje artikulli të Kosova.info, pas raportimit të dhunës në familje, gratë në Kosovë shpesh kalojnë nga një gjendje frike në një proces fuqizimi, duke u strehuar në qendra të posaçme ku marrin mbështetje psikologjike, juridike dhe profesionale.^[68] Ato marrin pjesë në kurse aftësimi si rrobaqepësie apo kompjuterike, marrin ndihmë për integrim social dhe, në disa raste, fillojnë edhe punë gjatë qëndrimit në strehimore, duke fituar pavarësi financiare.

^[66] CIEA, Përgjigje Drejtoriale për Ministria Sociale, Komuna e Prishtinës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 27 prill 2026

^[67] Po aty

^[68] Kosova.info, Nga frika te fuqizimi: Çka i pret gratë pas raportimit të dhunës në familje?, 2025

Megjithatë, sfidat mbeten të mëdha, pasi shumë gra hezitojnë të raportojnë dhunën për shkak të frikës, varësisë ekonomike dhe mungesës së informacionit për të drejtat e tyre. Artikulli nënvizon gjithashtu se strehimoret luajnë rol të rëndësishëm në ndërprerjen e ciklit të dhunës dhe në mbështetjen e grave për të rindërtuar jetën e tyre me më shumë siguri dhe vetëbesim.^[69]

DËNIMET E ULËTA NDAJ ABUZUESVE TË GRAVE

Sipas të dhënave të ofruara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në vitin 2025 janë regjistruar 3,109 raste të reja të Dhunës në Familje me 3,757 persona, duke e çuar numrin në 3,975 raste me 4,960 persona që ishin në trajtim.^[70] Sipas KPK numri i rasteve të zgjidhura në 2025 ishte 2,835 raste me 3,313 persona.

Shumica e rasteve janë trajtuar përmes ngritjes së aktakuzave, me 1,457 aktakuza të drejtpërdrejta dhe 1,135 pas procedurës hetimore. Ndërkohë, një pjesë më e vogël përfshin hedhjen e kallëzimeve penale (403 persona), pushimin e hetimeve (209 persona), si dhe masa të tjera si urdhri ndëshkimor (30 persona), trajtimi i detyrueshëm (59 persona) dhe cedimi i kompetencës (20 persona). Sipas KPK, 1,876 persona përfunduan me aktgjykim fajësues dhe 54 persona masa e trajtimit të detyrueshëm.^[71]

Raporti i GLPS mbi monitorimin e rasteve të dhunës në familje, për vitin 2025, thekson se gjykatat e shkallës së parë kanë pranuar gjithsej 1007 raste për veprën penale "Dhunë në familje", prej të cilave 568 janë zgjidhur, ndërsa 439 kanë mbetur të pazgjidhura gjatë periudhës raportuese.^[72] Ndër, to shkalla e zgjidhjes në Kosovë ishte 56%, dhe mesatarja e

^[69] Po aty

^[70] OJKA, *Përgjigje e Këshillit Prokurorial i Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike*, Prill 15, 2026.

^[71] Po aty

^[72] GLPS, *Performanca dhe Megjithësi: Trajtimi i Dhunës në Familje në 2025*, 2026.

kohes është 281 ditë duke treguar sfida në menaxhimin efektiv të rasteve nga gjykatat, raporton GLPS.

Raporti "Performanca dhe Mangësitë: Trajtimi Institucional i Dhunës në Familje në 2025" nga GLPS thekson se:

- Mbi 87% e të akuzuarve për dhunë në familje janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar nga gjykatat
- Në 487 nga 568 raste të zgjidhura, të pandehurit kanë pranuar fajësinë e tyre lidhur me akuzën për veprën penale të dhunës në familje
- Nga 495 raste ku gjykatat kanë dhënë vendime fajësie, vetëm në 145 raste janë shqiptuar dënime efektive si burgim, burgim dhe gjobë, si dhe vetëm gjobë
- Në rreth 70% të rasteve shqiptohen dënime me kusht.

DHUNA
SEKSUALE

DHUNIMI DHE SULMI SEKSUAL

Sipas të dhënave zyrtare nga Databaza për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje e Ministrisë së Drejtësisë, gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 4 raste të dhunimeve seksuale brenda familjes, të cilat janë evidentuar në katër qytete të ndryshme: Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Gjakovë.^[73]

Gjykata e Apelit në Kosovë i ka ulur dënimin një ish-mësimdhënësi i cili ishte dënuar për sulm seksual ndaj një nxënëseje të mitur dhe kanosje të një dëshmitari, duke ia zbritur dënimin nga 15 vjet e 6 muaj në 3 vjet e 6 muaj burg. Vendimi u morr pas ankesës dhe ricilësimit të veprës penale, ku Apeli ndryshoi edhe kualifikimin juridik të rastit dhe e rishqyrtoi lartësinë e dënimit, duke përfshirë edhe kohën e kaluar në paraburgim.^[74]

Sipas një artikulli të Radio Europa e Lirë, ngacmimi dhe sulmi seksual lidhet me mendësinë patriarkale dhe mungesë të edukimit të mjaftueshëm për pëlqimin, duke treguar se në shkolla edukata seksuale ekziston vetëm në mënyrë të shpërndarë në disa lëndë dhe shpesh fokusohet më shumë te shëndeti riprodhues sesa te koncepti i pëlqimit, gjë që sipas ekspertëve e bën të pamjaftueshëm formimin e të rinjve për këtë temë.^[75]

DHUNA SEKSUALE GJATË LUFTËS

Gjatë vitit 2025 janë pranuar gjithsej 198 aplikacione për njohje të statusit “viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës”. Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës ka miratuar 164 kërkesa (152 gra dhe 12 burra), ndërsa ka refuzuar 41 kërkesa (32 gra dhe 9 burra).^[76]

Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me 15 vite burg Zhivojin Nesiqin për krime lufte, përkatësisht dhunim seksual ndaj një viktime shqiptare gjatë luftës në Kosovë.^[77] Në mars të vitit 2026, Gjykata e Apelit uli këtë dënim në 13 vjet.^[78]

^[73] Ministria e Drejtësisë, <https://mda-ko.gov.net/publikimet/statistikat/>

^[74] OIRA, *“Gjykata e Apelit ia zvogëlon çdo 12 vjet dënimin mësimdhënësit të cilin e dënoi për sulm seksual”*, 2025

^[75] Radio Europa e Lirë, *“Problemet në shkollë për refuzim” Çka mëson në shkollë dhe çka jo gjatë në Kosovë për çelësimin?*, 2025

^[76] OIRA, *Përgjigje e Komisionit ndaj kërkesës për qasje në informata publike*, 16 prill 2026.

^[77] OIRA, *Gjykata dënon me 15 vjet burg Zhivojin Nesiqin për dhunim seksual gjatë luftës*, 2025

^[78] Betimi për Drejtësi, *Apeli ia ul dënimin në 13 vjet burgun Zhivojin Nesiqin i akuzuar për dhunim seksual gjatë luftës në Kosovë*, 2026

NGACIMET SEKSUALE

Në 2025 është mbajtur shqyrtimi fillestar gjyqësor ndaj Xhevat Krasniqit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku ai akuzohet për ngacmim seksual ndaj disa studenteve të Universitetit të Prishtinës, raporton OIKA. Sipas aktakuzës, rasti lidhet me sjellje të pretenduara gjatë ushtrimit të funksionit të tij si profesor dhe me raport të pabarabartë pushteti. Gjatë seancës, ai është deklaruar i pafajshëm, ndërsa rasti bazohet në denoncimet e disa studenteve dhe ngre shqetësime për trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në universitet.^[79]

Në Kosovë është lansuar aplikacioni "The Sorority", një platformë ndërkombëtare e krijuar për të ofruar mbështetje dhe siguri, kryesisht për gratë dhe grupet e cënueshme. Aplikacioni mundëson lidhje mes përdoruesve për ndihmë në situata të pasigurta, ndarje informacionesh dhe krijim të një rrjeti solidariteti e mbrojtjeje në komunitet.^[80]

Lajmi.net raportoi se Policia e Kosovës ka nisur zbatimin e një plani operativ në veri të vendit, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimeve seksuale ndaj grave.^[81] Për këtë është krijuar një grup pune i përbërë nga njësi të ndryshme policore, përfshirë edhe Policinë Kufitare dhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa procesi monitorohet nga Inspektorati Policor dhe EULEX-i.^[82]

Nisma ka ardhur pas raportimeve dhe denoncimeve për raste të ngacmimeve seksuale në këtë zonë, si dhe shqetësimeve të ngritura nga qytetarët për mungesë të besimit në institucionet e sigurisë dhe nevojën për reagim më efektiv institucional.^[83]

^[79] OIKA, "Ushtrat shqyrtimi fillestar gjyqësor ndaj Xhevat Krasniqit," 2025

^[80] OIKA, "Lancohet në Kosovë aplikacioni 'The Sorority'," 2025

^[81] Lajmi.net, "Policia e Kosovës me plan operativ për parandalimin e ngacmimeve seksuale në veri," 2025

^[82] Po aty

^[83] Radio Evropa e Lirë, "Policia e Kosovës me plan operativ për ngacmimet seksuale në veri," 2025

DHUNA PËRMES TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Në 2025, Flutura Kusari ushtroi kallëzim penal ndaj Mentor Llugalet për ngacmim të vazhdueshëm online, i cili sipas pretendimeve ka zgjatur rreth tre vite.^[84] Ajo ka deklaruar se është përballur me një numër të madh publikimesh denigruese dhe kërcënuese në rrjete sociale. Prokuroria Themelore ka hudhur kallximin penal dhe ajo e Apelit refuzoi ankesën e Kusarit.^[85]

Të dhënat personale të gazetares Ardiana Thaqi Mehmeti u shpërndanë ilegalisht në një grup në Discord me rreth 70 mijë anëtarë, duke rezultuar në ngacmime ndaj saj.^[86]

Sipas Betimit për Drejtësi, dhuna digjitale ndaj grave në Kosovë është një fenomen në rritje, por mbetet kryesisht e nën-raportuar për shkak të frikës, stigmatizimit dhe mungesës së besimit në institucione.^[87] Format më të shpeshta përfshijnë ngacmimet online, kërcënimet, shpërndarjen e paautorizuar të të dhënave dhe materialeve intime, të cilat shkaktojnë pasoja serioze psikologjike dhe sociale për viktimat.^[88] Sipas UN Women, më shumë se 90% e përmbytjeve të manipuluar digjitale (deepfake) synojnë gratë, raporton Betimi për Drejtësi.

GRATË NË SFERËN PUBLIKE

Sipas Fondacionit Jahjaga, pavarësisht kornizës ligjore për barazinë gjinore në Kosovë, gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse për shkak të stereotipeve, perceptimeve patriarkale dhe rrjeteve joformale.^[89] Në analizen e këtij Fondacioni theksohet se 70% e të anketuarve besojnë se përfshirja më e madhe e grave në pozita udhëheqëse do të përmirësonte cilësinë e vendimmarrjes në institucione publike të Kosovës.

^[84] OJKA, "Flutura Kusari eçit Mentor Llugalet për ngacmim online tre vjetor," 2025

^[85] Betimi për Drejtësi, "Prokuroria e Apelit refuzoi ankesën e Kusarit kundër vendimit të Prokurorisë Themelore për hedhjen e kallëzimit penal ndaj Llugalet," 2025

^[86] Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), "Të dhënat personale të gazetares Ardiana Thaqi Mehmeti shpërndanë në një grup me 70 mijë anëtarë në Discord," 2025

^[87] Betimi për Drejtësi, "Si është e rëndësishme dhuna digjitale ndaj grave dhe sa raportohet ajo?," 2025

^[88] Po aty.

^[89] Fondacioni Jahjaga, "Pse gratë në institucionet publike të Kosovës rritëherë arrijnë në pozitat më të larta?," 2025

QIKA, në një reagim të vitit 2025, dënoi përdorimin e gjuhës denigruese dhe seksiste nga kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ndaj ish-deputetes dhe aktorese Adriana Matoshi.^[90] Organizata theksoi se sulmet personale të bazuara në stereotipe gjinore përbëjnë formë të dhunës strukturore që cenon pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe demokracinë në përgjithësi. QIKA bëri thirrje për debat publik të bazuar në argumente dhe për ndalimin e normalizimit të gjuhës së urrejtjes dhe mizogjinisë në diskursin politik dhe institucional.^[91]

Sipas të dhënave të KQZ-së për vitin 2025, pjesëmarrja e grave si kandidatë mbetet më e ulët në garat për kryetarë komunash (9.76%), ndërsa është dukshëm më e lartë në zgjedhjet për kuvende komunale (37.35%) dhe në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës (33.14%).^[92] Megjithatë, në përfaqësimin e zgjedhur, gratë përbëjnë shumicën në kuvendet komunale (604 gra kundrejt 338 burrave), por mbeten më pak të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës (40 gra kundrejt 80 burrave). KQZ thekson se nuk ka mandat të drejtpërdrejtë për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, pasi kjo përgjegjësi u takon kryesisht subjekteve politike dhe respektimit të kuotave ligjore.

^[90] QIKA, *Gjuha e urrejtjes dhe mizogjia nuk kanë vend në diskursin publik*, 2025

^[91] Po aty

^[92] QIKA, *Përgjigje e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ndaj kërkesës për qasje në informata publike*, Prill 17, 2026

TABELA 2: NGA KOMISIONIT QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet / Institucioni	Gra (numër / %)	Burra (numër / %)	Totali
Kryetarë komunash (kandidatë)	20 (9.76%)	185 (90.24%)	205
Kuvende komunale (kandidatë)	2,024 (37.35%)	3,395 (62.65%)	5.419
Kuvendi i Kosovës (kandidatë)	391 (33.14%)	789 (66.86%)	1.180
Kuvende komunale (të zgjedhur/a)	604	338	942
Kuvendi i Kosovës (të zgjedhur/a)	40	80	120

FEMICIDI

NUK KA PAKET
PA
GURINË E GRAVE

Në përkujtim të të gjitha viktimave të femicidit.
Qoftë kujtimi i tyre një thirrje për drejtësi,
llogaridhënie dhe një shoqëri ku asnjë grua të
mos humbasë jetën nga dhuna me bazë gjinore.

Foto: Florent Kurtalani

Në periudhën nga viti 2010 deri në mars 2025, në Kosovë janë regjistruar gjithsej 59 raste të vrasjes së grave.^[93] Sipas statistikave, përgjatë vitit 2025 në Kosovë u vra 1 grua.^[94] Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka bërë të ditur se më 24.03.2025, në Vushtrri, një burrë dyshohet se fillimisht ka vrarë një grua dhe më pas ka kryer vetëvrasje, raporton Kallxo.com.^[95]

ZHVILLIMET NË VITIN 2025 RRETH RASTEVE TË TJERA TË FEMICIDIT NË KOSOVË

Erona Cokli (21 vjeçe)

Rasti i vrasjes së Erona Coklit përfaqëson një nga ngjarjet më të rënda të dhunës ndaj grave në Kosovë në vitet e fundit. Më 12 prill 2024, atë e vrau me armë zjarri ish-bashkëshorti i saj, Valon Aliu, brenda Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj. Gjykata Themelore në Ferizaj e shpalli Aliun fajtor për disa vepra penale dhe e dënoi me 24 vjet burgim, një vendim që u konsiderua i rëndësishëm për llogaridhënien, por që njëkohësisht ngjalli pakënaqësi të familjarët e viktimës dhe mbetet subjekt i procedurave të mëtejshme ankimore.^[96]

Gjyljeta Ukelli (43 vjeçe)

Gjyljeta Ukelli u vra me 16 prill 2024 në banesën e saj nga ish-bashkëshorti i saj Edmond Lajqi. Dorasi ishte vetëdorëzuar në Polici.^[97] Me 27 dhjetor 2024, Gjykata Themelore në Pejë ka dënuar me burgim të përjetshëm Edmond Lajqin për vrasjen e Gjyljeta Ukellit.^[98] Në 2025, Apeli ka lënë në fuqi dënimin me burgim të përjetshëm për Edmond Lajqin, duke e refuzuar ankesën e mbrojtjes dhe duke e konfirmuar vendimin e Gjykatës Themelore në Pejë.^[99]

^[93] Radio Evropa e Lirë, Gra të vrara në Kosovë, 2025

^[94] Ministria e Drejtësisë, Statistika ekr e vrasjeve të dhunës në familje

^[95] Kallxo.com, Vrasja e dytë në Vushtrri - Prokuroria i ka detajet, 2025

^[96] KCHW.net, Valon Aliu dënohet me 24 vjet për vrasjen e ish-bashkëshortes Erona Cokli, 2024

^[97] Radio Evropa e Lirë, Burgim i përjetshëm për të akuzuarin që vrasjen e bashkëshortes në Pejë, dhjetor 2024.

^[98] Po aty.

^[99] OCHA, Apeli të në fuqi dënimin e Lajqit me burgim të përjetshëm për vrasjen e Gjyljeta Ukellit, 2025

Liridona Ademaj (30 vjeçe)

Në nëntor 2023, një person e vrau me armë zjarri Liridona Ademajn gjersa ajo ishte në makinë me partnerin e saj dhe fëmijët e tyre. Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me burgim të përjetshëm Naim Murselin dhe Granit Plavën për vrasjen e Liridona Ademajt, ndërsa Kushtrim Kokalla është dënuar me 30 vjet burg, në një rast që sipas aktakuzës ishte i planifikuar nga vetë bashkëshorti i viktimës, i cili kishte organizuar krimin përmes pagesës ndaj dorasit.^[100]

Maria Clara Urgandaray (27 vjeçe)

Endrit Nika është dënuar me 18 vjet burg nga Gjykata Themelore në Prishtinë për vrasjen e Maria Clara Urgandaray, shtetase argjentinase, pasi sipas aktakuzës ai e kishte sulmuar viktimën dhe më pas e kishte hedhur nga kati i gjashtë i një hoteli, ku ajo ndërroi jetë pavarësisht trajtimit mjekësor.^[101]

Marigona Osmani (18 vjeçe)

Marigona Osmanin e vranë me 21 gusht të vitit 2021. Pas një shqyrtimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, është vërtetuar aktgjykimi i gjykatave më të ulëta ndaj Dardan Krivaqës, duke lënë në fuqi dënimin me burgim të përjetshëm për veprën penale të vrasjes së rëndë të Marigona Osmanit. Gjykata Supreme ka refuzuar ankesën e mbrojtjes dhe ka konstatuar se vendimet e mëhershme janë të bazuara në prova dhe nuk përmbajnë shkelje esenciale procedurale, duke konfirmuar kështu përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe dënimin maksimal të shqiptuar ndaj tij.^[102]

Sadije Godeni

Në 2024 Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar Izet Godenin me 35 vjet burgim për vrasjen e bashkëshortes së tij, Sadije Godeni, një ngjarje që ka ndodhur më 25 nëntor 2022 në shtëpinë e tyre në Prishtinë. Sipas aktgjykimit, ai e ka vrarë atë në mënyrë mizore me sëpatë derisa ajo ishte duke fjetur, dhe vendimi u konfirmua edhe pas rigjykimit dhe ankesave në Apel.^[103]

^[100] OJKA, Burgim i përjetshëm për Murselin e Plavën, 30 vjet për Kokallën, 2023

^[101] Betimi për Dreytën: Endrit Nika dënohet me 18 vjet burgim për vrasjen e argjentinases në Fushë Kosovë, 2023

^[102] Betimi për Dreytën: Surroni e vërtetoi dënimin me burgim të përjetshëm për Dardan Krivaqën, 2023

^[103] OJKA, Dënohet me 35 vjet burgim Izet Godeni për vrasjen e bashkëshortes së tij, 2024

